

## Termet e Referencës

Hulumtim: Qasshmëria dhe Disponueshmëria e Shërbimeve Publike për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në Zonat Rurale

### I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983.

Si organizatë përfaqëson, përkrah dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuar përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

### II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Advancing Rights and Participation of Children with Disabilities in Kosovo”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Projekti përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të monitoruar të drejtat e tyre dhe për të ndikuar në vendimmarrje në nivel lokal.

### III. OBJEKTIVA E DETYRËS

Fëmijët me aftësi të kufizuara që jetojnë në zonat rurale shpesh përballen me vështirësi të shumta në qasjen në shërbimet bazike publike. Për të kuptuar më mirë situatën aktuale dhe për të identifikuar pengesat ekzistuese, do të realizohet një hulumtim që do të analizojë disponueshmërinë dhe qasshmërinë në shërbimet publike për fëmijët me aftësi të kufizuara në një zonë rurale të përzgjedhur.

Qëllimi i hulumtimit është të vlerësojë nëse dhe në çfarë mase fëmijët me aftësi të kufizuara që jetojnë në zona rurale kanë qasje në shërbime publike bazike, duke përfshirë arsimin, shërbimet shëndetësore, rehabilitimin, transportin dhe shërbimet sociale, si dhe të identifikojë pengesat strukturore dhe institucionale që ndikojnë në përjashtimin e tyre.

Objektivat Specifike:

- Të identifikojë shërbimet publike që janë në dispozicion për fëmijët me aftësi të kufizuara në zonën e përzgjedhur rurale.
- Të analizojë nivelin e qasjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në këto shërbime.
- Të evidentojë pengesat kryesore fizike, institucionale, financiare dhe sociale që kufizojnë qasjen në shërbime.
- Të mbledhë perspektivat e familjeve, ofruesve të shërbimeve dhe institucioneve lokale lidhur me sfidat ekzistuese.
- Të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimin e qasjes në shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara në zonat rurale.

Metodologjia do të përfshijë:

- Rishikimin e dokumenteve dhe politikave relevante.
- Pyetësorë me prindër dhe familjarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Pyetësorë me ofrues të shërbimeve publike (arsim, shëndetësi, rehabilitim, shërbime sociale dhe transport).
- Analizën e të dhënave të mbledhura dhe hartimin e raportit përfundimtar.

#### IV. KUALIFIKIMI

Eksperti/ja i/e angazhuar për këtë aktivitet duhet të ketë:

- Përvojë në realizimin e hulumtimeve sociale dhe analizave të politikave publike.
- Njohuri mbi të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- Përvojë në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave cilësore.
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe raportuese.
- Njohje e kontekstit institucional dhe ligjor në Kosovë.

#### V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja do të jetë përgjegjës/e për:

Planifikimin dhe realizimin e hulumtimit;  
Zhvillimin e metodologjisë dhe instrumenteve të mbledhjes së të dhënave;  
Organizimin dhe zhvillimin e pyetësorëve në terren,  
Analizimin e të dhënave të mbledhura dhe hartimin e raportit përfundimtar me gjetje;  
Përfundime dhe rekomandime konkrete për institucionet përkatëse.

*Shënim: Për të garantuar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të mbledhura, HANDIKOS rezervon të drejtën që të kontaktojë një pjesë të respondentëve për të verifikuar realizimin e pyetësorëve dhe saktësinë e informacionit të ofruar. Çdo kontakt i tillë do të kryhet në përputhje me parimet e konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe standardeve etike të hulumtimit.*

#### VI. ANGAZHIMI I EKSPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Korrik 2026 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Hartimi i metodologjisë së hulumtimit dhe instrumenteve për mbledhjen e të dhënave	2 ditë
Mbledhja e të dhënave në terren	5 ditë
Analizimi i të dhënave të mbledhura	3 ditë

Hartimi i raportit të hulumtimit	2 ditë
TOTALI	12 ditë

## VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa do të bëhet pas përfundimit të aktivitetit dhe dorëzimit të raportit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizojë pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

*HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.*

## VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim;
- Curriculum Vitae (CV);
- Propozimi financiar.

Aplikimet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: [nora.simitciu@handi-kos.org](mailto:nora.simitciu@handi-kos.org).

Ju lutem, shkruani në subjekt:

Hulumtim- Qasshmëria dhe Disponueshmëria e Shërbimeve Publike për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është 16 Korrik 2026.**

**Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!**

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve** si dhe **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kritereve të tyre.